



# RENOFIX 370

LLAÇ MINERAL STRUKTURAL  
(ABRIB) PËR MURE

## Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

### HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Llaç i thatë i fabrikuar sipas EN 998-1. Llaç mineral, johidrofob, struktural, final për fasada dhe hapësira të brendshme, mbi llaçe themelore dhe llaçe për izolim termik.

### PËRMBAJTJA:

- Gëlqere e hidratizuar
- Çimento e bardhë
- Rërë të bardhë mermeri të klasuar me granulacion të ndryshëm
- Komponentë lidhës

### VEÇORITË:

- Ekologjikisht i preferuar
- Pa lëndë lidhëse organike

### PËRGATITJA E BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri dhe mbeturinat. Llaçet themelore të gipsit apo çimentos duhet të jenë të thatë plotësisht dhe të pastër. Tërë sipërfaqja apo pllakat e gipskartonit duhet paraprakisht të rrafshohen (shpaklohen) mirë me Renofix 15 i bardhë ose Renofix 18. Renofix 370 mund të vendoset pasi të jenë thatë llaçet themelore.

### PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 370 zbrazet në 6.3-6.7 litra ujë të pastër dhe përziehet me mikser deri sa të fitohet masë homogjene. Pas përzierjes lihet të qëndrojë për 10 minuta. Më pas përsëri përziehet dhe vendoset mbi bazamentin.

### PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT:

Llaçi vendoset me rrafshues metali (gletkele). Strukturimi i llaçit arrihet me fërkuese të posaçme për filcim (nga stiropori apo plastika). Trashësia e shtresës varet nga madhësia e thërmisë (granulës). **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzierja me materiale tjera.



### VËRREJTJE:

Përmban gëlqere të shuar dhe çimento të bardhë. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, lëkura të lahet me ujë të pastër, ndërsa për sytë kërkoni ndihmën e mjekut.

### PAKETIMI:

Renofix 370 paketohet dhe shpërndahet në thasë letre nga 25 kg. që janë të mbrojtur nga lagështia.



### DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj.

Të dhëna teknike	
Numri i prodhimit	5319990620224
Shifra e prodhimit:	1370,5   1371   1372   1373
Thasë në paletë:	42

# RENOFIX 370


<b>Granulacioni:</b>	0,5 mm	1 mm	1,5 mm	1,5 mm	2 mm	2 mm	3 mm
<b>Sasia e nevojshme e ujit:</b>	6,3 - 6,7 l./thesi						
<b>Struktura e materialit dekorues:</b>		R	R	V	R	V	R
<b>Ngjyra:</b>	Krem						
		12.5 deri 13.5 m <sup>2</sup> /EN	10 deri 11,5 m/EN	10 deri 11,5 m <sup>2</sup> /EN	7.5 deri 9 m <sup>2</sup> /EN	7.5 deri 9 m <sup>2</sup> /EN	6 deri 6.5 m <sup>2</sup> /EN
<b>Harxhimi:</b>	1,5 deri <sub>2</sub> 1,6 kg/m <sup>2</sup>	2 deri <sub>2</sub> 2,1 kg/m <sup>2</sup>	2,2 deri <sub>2</sub> 2,5 kg/m <sup>2</sup>	2,2 deri <sub>2</sub> 2,5 kg/m <sup>2</sup>	2,8 deri <sub>2</sub> 3,3 kg/m <sup>2</sup>	2,8 deri <sub>2</sub> 3,3 kg/m <sup>2</sup>	4 deri <sub>2</sub> 5 kg/m <sup>2</sup>
<b>Shënim:</b>	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.						
<b>Dendësia e materialit kur është i thatë:</b>	ca. 1300 kg/m <sup>3</sup>						
<b>Përçueshmëria e nxehtësisë (EN 1745:2002):</b>	ca. 0,54 W/mK						
<b>Kapacitet i veçantë i nxehtësisë:</b>	ca. 1 J/kgK						
<b>Vlera - pH</b>	ca. 12						
<b>Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):</b>	ca. 1,0 N/mm <sup>2</sup>						
<b>Reagimi gjatë djegjes (EN 13501-1):</b>	A 1						
<b>MG (EN 998-1):</b>	CR CS I W0						


## Udhëzime të përgjithshme:

COMPANY CERTIFIED BY




**EN ISO 9001**  
Certificate No: FM 503328

Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: [www.renova.com.mk](http://www.renova.com.mk) si  ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



- 1 RENOFIX 5
- 2 Stiropor ose lesh mineral
- 3 Diblla për stiropor
- 4 RENOFIX 5 I BARDHË
- 5 Rrjetë për armim
- 6 RENOFIX 5 I BARDHË
- 7 RENOFIX 370-1,2,3 mm

MUR ME TERMOIZOLIM



- 1 RENOFIX 10
- 2 RENOFIX 18
- 3 RENOFIX 370

MUR PA TERMOIZOLIM

RENOVA PUTZ | [www.renova.com.mk](http://www.renova.com.mk)

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | [info@renova.com.mk](mailto:info@renova.com.mk)  
 RENOVA Gureza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | [renova\\_ferizaj@hotmail.com](mailto:renova_ferizaj@hotmail.com)  
 RENOVA Vore, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | [renova.tirana@hotmail.com](mailto:renova.tirana@hotmail.com)